

**STATUTI DHE AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**RUKA Construction Sh.P.K**

Mbi bazën e kërkesave te ligjit Nr. 9901 te datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe te ligjit Nr. 9723 te datës 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, krijohet shoqëria tregtare RUKA Construction Sh.P.K, e cila do te veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**KREU I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

- (1) Sot, ne Fushe-Kruje më 16.12.2024, unë **Sokol Ruka**, mbajtës i dokumentit te identifikimit me ID nr. **I40721066V**, vendosa si Ortak i Vetëm Themelimin e Shoqërisë Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar me emrin **RUKA Construction Sh.P.K.**
- (2) Themeluesit i shoqërisë **RUKA Construction Sh.P.K.**, është **Sokol Ruka**, shtetas/Shqiptar, lindur në Bruç, Mat, dhe banues në Fushe-Kruje.

**Neni 2:**  
**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Import-eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të artikujve industrial, bujqësore, ndërtimore, elektroshtëpiake, audiovizive, elektrike, të makinerive për ndërtim.
- Punime ndertimi te cfarendojoj dhe rikonstruksione, projektimin dhe zbatimin, pa u kufizuar i veprave urbane, civile, industriale, arkitekturore, rrugore dhe hekurudhere, urave dhe veprave të artit, si dhe punime inxhinierike topografike dhe hidrologjike, inxhinierike te impianteve te prodhimit dhe transmetimit te energjisë etj.
- Punime germimi ne toke.
- Punime per prishjen e ndertimeve.
- Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.
- Ndertime civile dhe industriale.
- Rikonstruksion dhe mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- Ujsjelesa, gazsjelesa, vajsjelesa, vepra kullimi vadirje.
- Impiente hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.
- Sinjalistika rrugore jo ndricuese.
- Barriera dhe mbrojtje rrugore.

**Neni 3:**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do te ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë se saj me një afat kohor te pacaktuar.

**Neni 4:**  
**Selia**

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën:  
**Lagjja e re Rr. Krujes, Zona kadastrale 1665 Nr.pasurie 255/65, Fushe-Kruje, Kruje.**
- (2) Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është: **www.rukaconstruction.al**
- (3) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: **sokolruka86@gmail.com**



## Kreu II KAPITALI

### Neni 5 Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është 10,000 (dhjete mijë) Lekë.  
(2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortaku i vetëm themelues, **Sokol Ruka** është zotëruar i 1(një) kuote me vlerë nominale të përgjithshme 10,000 (dhjete mijë) Lekë që përbën 100 (njëqind) % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë; ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 8 Organi Vendimmarrës

- 8.1 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.
- 8.2 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - 8.2.1 përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - 8.2.2 ndryshimet e statutit;
  - 8.2.3 emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - 8.2.4 emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - 8.2.5 përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - 8.2.6 mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

- 8.2.7 miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; e)  
zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - 8.2.8 pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - 8.2.9 përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - 8.2.10 riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - 8.2.11 miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - 8.2.12 çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.3 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.4 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.5 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 8.6 Te drejtat dhe detyrimet e asamblesë se përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Te gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër te vendimeve, te dhënrat e te cilat nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
  - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

#### **Neni 9 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit te pare të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10 Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

#### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave te zotëruesh te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.



Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKR për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

#### Neni 12

##### Përjashtimi nga e drejta e votës

- 12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.
- 12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 13 Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Administratoret e shoqerise per një periudhe 5(pese) vjeçare do te jete.

1- Sokol Ruka me Nr Id I40721066V me banim ne Fushe-Kruje.

#### Neni 14 Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



7. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

*Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:*

1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
2. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 15**  
**Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:

1. të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdësi;
2. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
3. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, përfundimisht, përfundimisht, përfundimisht, përfundimisht, përfundimisht;
4. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
5. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të



parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkeshë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET**

##### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimi i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17 Ekspertet**

Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'ja paraqesë e dorëzoje ne kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

#### **Kreu V PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

##### **Neni 18 Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe :

1. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
2. me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
3. me hapjen e procedurave të falimentimit;
4. ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
5. me vendim të gjykatës;



Ne ketë rast Ortaket merrni vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërite tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.  
Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrni një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."


**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Për sa nuk parashikohet ne ketë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
RUKA Construction Sh.P.K**

  
Sokol Ruka  
Emri i mësimdhënës (nënshtetje)